



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1127/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Safet Osmani kandidat për asamble kuvendit komunale nga subjekti politik Partia Demokratike e (PDK) në Vushtri, paraqitur kundër komisionerëve të qendrave të vendvotimeve, për shkak të parregullsive dhe manipulimit të votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Safet Osmani kandidat për kuvendin komunal në Vushtri nga radhët e subjektit politik PDK.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Hamit Xhafri anëtarë për asamble komunale nga subjekti politik PDK dega në Vushtri, i cili pretendon se në rezultatet e publikuara nga KQZ-ja në qendrat e votimit me numër 2703 B, 2711B, 2706B, 2702B, 2717B si dhe në vendvotimin me numër 2726B, i cili mendon se i mungojnë një numër i konsideruar i votave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Safet Osmani nga komuna e Vushtrisë. PZAP-i, vlerësoi si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1127/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.